



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr 4318 Prot

Elbasan më 18 /09/2024

RELACION

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin GUSHT 2024

KËSHILLIT BASHKIAK

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 11 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Propozojmë:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin GUSHT 2024 gjithsej 52 familje me një fond gjithsej 147.800 lekë.
Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit.
Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka

Konfirmoi: D.Rroseni

Zv/Kryetari

Armand Shehu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan më ____/09/ 2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ datë ____/09/ 2024

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin GUSHT 2024

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/09/2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 11 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin GUSHT 2024 për 52 familje me një fond prej 147.800 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Përgj Kujdesit Social
Drejtori Juridik

D.Rroseni
A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Elvi Çuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. Prot 4317

Elbasan më 18 /09/2024

RELACION

**Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin GUSHT 2024
KËSHILLIT BASHKIAK**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 12 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, paraqesim për miratim propozimin e familjeve që do trajtohen nga fondi i kushtëzuar.

**I. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin GUSHT 2024 ,
223 familje me një fond prej 956.864 lekë.**


Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .

Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka 

Pranoi: D.Rroseni 

ZV/KRYETARI
ARMAND SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan më ____/09/ 2024

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ datë ____/09/2024

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin GUSHT 2024

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/09/2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DPPSSSHKI, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 12 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin GUSHT 2024 për 223 familje me një fond prej **968.607** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Kujdesit Social

D.Rosemi

Drejtori Juridik

A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL
SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE
AFTËSISË SË KUFIZUAR

INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN
GUSHT 2024

I. Ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin GUSHT 2024

GUSHT	223 familje	fondi	968.607
KORRIK	219 familje	fondi	933.689

Për muajin GUSHT 2024 kemi 4 familje më shumë në krahasim me muajin Korrik 2024, nga lista totale e familjeve që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar.

Fondi i shpenzuar është 34.918 lekë më shumë se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar janë:

1. Albert Ferra (nuk paraqitet)
2. Nazmi Debrova (ka aplikuar në sistem)
3. Shaip Cekrezi (nuk paraqitet)
4. Djana Cerekja (del ne pension)
5. Aleksander Lici (ka aplikuar në sistem)
6. Petrit Sula (ka aplikuar ne sistem)
7. Skender Dani (del ne pension)
8. Tefik Spahiu (ka fituar ne system)
9. Suzana Tabaku (nuk paraqitet)

II. Ndihma ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Maj 2024

GUSHT	52 familje	fondi	147.800
KORRIK	55 familje	fondi	158.800

Për muajin GUSHT 2024 kemi 3 familje më pak që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi është 11.000 lekë më pak se muaji paraardhës.



BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL
SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE
AFTËSISË SË KUFIZUAR

INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN
GUSHT 2024

I. Ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin GUSHT 2024

GUSHT	223 familje	fondi	968.607
KORRIK	219 familje	fondi	933.689

Për muajin GUSHT 2024 kemi 4 familje më shumë në krahasim me muajin Korrik 2024, nga lista totale e familjeve që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar.

Fondi i shpenzuar është 34.918 lekë më shumë se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar janë:

- | | |
|--------------------|-------------------------|
| 1. Albert Ferra | (nuk paraqitet) |
| 2. Nazmi Debrova | (ka aplikuar në sistem) |
| 3. Shaip Cekrezi | (nuk paraqitet) |
| 4. Djana Cerekja | (del ne pension) |
| 5. Aleksander Lici | (ka aplikuar në sistem) |
| 6. Petrit Sula | (ka aplikuar ne sistem) |
| 7. Skender Dani | (del ne pension) |
| 8. Tefik Spahiu | (ka fituar ne system) |
| 9. Suzana Tabaku | (nuk paraqitet) |

II. Ndihma ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Maj 2024

GUSHT	52 familje	fondi	147.800
KORRIK	55 familje	fondi	158.800

Për muajin GUSHT 2024 kemi 3 familje më pak që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi është 11.000 lekë më pak se muaji paraardhës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Nr. 4915 Prot.

Elbasan 18.09. 2024

RELACION

“Për ngritjen e memorialit në përkujtim të qëndresës dhe ngjarjeve më të rëndësishme të zonës nga sundimi turk deri pas luftës së dytë botërore (në fshatin Seltë, Nj. A. Zavalinë)”

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë!

Vendosja e veprave të artit siç është edhe memoriali është mënyra më e përshtatshme për të përkujtuar figura dhe ngjarje historike

Bazuar në kërkesën nr.1158 prot. datë 02.07.2024 e ardhur nga Kryesia e fshatit Seltë (Njësia Administrative Zavalinë), po ju paraqesim relacionin për ngritjen e një memoriali, në qëndër të këtij fshati *“Në përkujtim të qëndresës dhe ngjarjeve më të rëndësishme të kësaj zone”*

Zona e Shpatit njihet për rezistencën ndaj sundimit turk këtë gjë e vërteton kronologjia e ngjarjeve të renditura më poshtë.

Në Tetor të vitit 1908 në gjithë krahinën e Shpatit nga Shtërmeni deri në Zavalinë, u çelën zyrtarisht shkollat në gjuhën shqipe ku si mësues u emerua Kodhel (Mihal) Dedja për fshatrat Zavalinë, Nezhan dhe Seltë.

Nga Nëntori i vitit 1908 e deri në Janar të vitit 1910 vazhduan regjistrimet e popullsisë, të cilët në krahinën e Shpatit u shoqëruan me dhunë, plaçkitje dhe burgosje të popullsisë nga administrata turke, si kundërpërgjigje ndaj regjistrimit të popullsisë me emra të krishterë. Pas fitores së revolucionit xhonturk më 23 korrik 1908, 40 shpatarakë të udhëhequr nga Ymer (Kostandin) Dervishi, shkuan në zyrat e regjistrimit të administratës turke, ku u regjistruan me emra të krishterë.

Fshatarët e fshatit Seltë i rezistuan me armë të dërguarve të administratës turke për ti regjistruar në emra myslimanë, për këtë rezistencë u arrestuan krerët jo vetëm të fshatit Seltë por të krejt Shpatit, të cilët u dënuan nga gjykata penale e Elbasanit me afate të ndryshme burgimi (30.03.1910).

Me kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912 për Pavarësinë e Shqipërisë, fshatarët e Seltës dhe të Nezhanit krijuan çetën luftarake me 23 luftëtarë që drejtohej nga patrioti Lef Nosi.

Më 27.11.1912 u ngrit flamuri kombëtar nga patrioti Jonuz Dervishi

Në luftën e dytë botërore fshatarët e fshatit Seltë u rreshtuan në formacione të ndryshme luftarake në batalionin e Shpatit në brigadën 17 S dhe brigada të tjera.

Një kontribut te çmuar ka dhënë dhe jep grupi folklorik i Seltës i krijuar ne vitin 1967 dhe vazhdon edhe në ditët e sotme në ruajtjen dhe promovimin e vlerave te folklorit dhe etnografisë së fshatit Seltë dhe të gjithë zonës së Shpatit.

Duke ju referuar kërkesës së mësipërme, për të jetësuar këtë ngjarje të rëndësishme, Agjencia e Kulturës dhe Turizmit (Sektori i Kulturës) bazuar në: ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", ligjin nr.8744, datë 22.02.2001 "Per transferimin e pronave të paluajtshme te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", Ju paraqet kërkesën për dhënien e pëlqimit për vendosjen e këtij memoriali ne fshatin Seltë ***“Në përkujtim të qëndresës dhe ngjarjeve më të rëndësishme të zonës ndaj sundimi turk deri pas luftës së dytë botërore”***, në përputhje kjo edhe me Planin e Rregullimit te Territorit te Bashkisë Elbasan.

Shpenzimet për ngritjen e këtij memoriali, janë kontribut i banorëve të fshatit Seltë.

Bashkangjitur këtij relacioni do të gjeni dokumentacionin mbështetës.

Konceptoi: D.Kristo
Miratoi: A.Guni



KRYETARI BASHKISË
Gledian LLATJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ____ Prot.

Elbasan ____ . ____ .2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. ____ datë: ____ . ____ .2024

“Për ngritjen e memorialit në përkujtim të ngjarjeve më të rëndësishme të zonës nga sundimi turk deri pas luftës së dytë Botërore. (në fshatin Seltë, Njësia Administrative Zavalinë)”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Agjensia e Kulturës dhe Turizmit (Sektori i Kulturës), *për ngritjen e memorialit “Në përkujtim të qëndresës dhe ngjarjeve më të rëndësishme të zonës nga sundimi turk deri pas luftës së dytë botërore (në fshatin Seltë, Njësia Administrative Zavalinë)”* “mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”(i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Të miratojë ngritjen dhe vendosjen e memorialit *“Në përkujtim të qëndresës dhe ngjarjeve më të rëndësishme të zonës nga sundimi turk deri pas luftës së dytë botërore (në fshatin Seltë, Njësia Administrative Zavalinë)”*
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Elvi ÇUNI

KRYETARI
Lutfi LALA

Konceptoi:

Përgj sek.Kulturës: D.Kristo
Drejtoria Juridike: A. Hoxha
Drejtori i A.K.T: A.Guni



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN
KARTELA SHOQËRUESE PRAKTIKE

Dërgues K. Fshati Selte - A. Jaxari Nr. Prot. _____ Datë 1 / 1

Shkurtimi i lëndës Këllusë për ndërtim memorie

Për trajtim nga:	<u>K. Bashkia, A. Guni</u>
(Struktura të tjera të ngarkuara)	
Me porosi:	<u>[Signature]</u>

Afati ☐ Normal (7 ditë) ☐ Prioritet (3 ditë) ☐ Urgjent (brenda ditës) ☐ Pa afat/Për dijeni/Tjetër

Data 02/07/24 Nr. Prot. 1158 Nënshkrimi(_____)

Marrë në dorëzim 04/07/24 Nënshkrimi [Signature]

Kalim për trajtim (struktura) D. Krista E. Korrika 1 / 1

Me porosinë _____

Marrë në dorëzim _____ Nënshkrimi _____

Kalim për trajtim Specialisti _____ 1 / 1

Me porosinë _____

Trajtim i materialit përfunduar më 1 / 1 Specialisti _____

Trajtim i materialit pranuar më 1 / 1 Përgjegjës Sektori _____

Trajtim i materialit miratuar më 1 / 1 Sekretari i Përgjithshëm _____

1158
17.02.07.24

Këshilli i fshatit

Seltë

Këshillit Bashkiak Elbasan

Kryetarit të Bashkisë

Z.Gledian Llatja

Lënda:Kërkesë për ndërtim memoriali

Fshati Seltë ndodhet në njësinë administrative Zavalinë të Bashkisë Elbasan.

Në tetor të vitit 1908 u çelën zyrtarisht shkollat në gjuhën shqipe në gjithë krahinën e Shpatit,nga Shtërmëni deri në Zavalinë,ku u emërua mësues Kodhel(Mihal)Dedja për fshatrat Zavalinë,Nezhar dhe Seltë.

Nga nëntori i vitit 1909 e deri në janar 1910 vazhduan regjistrimet e popullsisë,të cilat në krahinën e Shpatit u shoqëruan me dhunë,plaçkitje dhe burgosje të popullsisë nga administrata turke,si kundërpërgjigje ndaj regjistrimit të popullsisë me emra të krishterë.(Pas fitores së Revolucionit xhonturk më 23 korrik 1908,40 shpatarakë të udhëhequr nga Ymer(Kostandin)Dervishi,shkuan në zyrat e regjistrimit të administratës turke,ku u regjistruan me emra të krishterë).Fshatarët e fshatit Seltë i rezistuan me armë të dërguarve të administratës turke për t'i regjistruar me emra myslimanë.Për këtë rezistencë u arrestuan krerët jo vetëm të fshatit Seltë por të krejt Shpatit, të cilët u dënuan nga gjykata penale e Elbasanit me afate të ndryshme burgimi(30/03/1910).

Në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912 për Pavarësinë e Shqipërisë fshatarët e Seltës dhe të Nezharit krijuan çetën luftarake me 23 luftëtarë që drejtohej nga patrioti Lef Nosi.Më 27/11/1912 u ngrit flamuri Kombëtar nga patrioti Jonuz Dervishi.

Në Luftën e Dytë Botërore fshatarët e fshatit Seltë u rreshtuan në formacione të ndryshme luftarake në batalionin e Shpatit,në brigadën e 17s dhe brigada të tjera.

Një kontribut të çmuar ka dhënë dhe jep grupi folklorik i Seltës i krijuar në vitin 1967 dhe vazhdon edhe në ditët e sotme në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të folklorit dh etnografisë së fshatit Seltë dhe të gjithë zonës së Shpatit.

Për të jetësuar këto ngjarje të rëndësishme,kërkojmë që të na jepet leja ndërtimore për ngritjen e një memoriali në qendër të fshatit Seltë me dimensione 3m lartësi dhe 1.7m gjërësi.Toka dhe shpenzimet janë kontribuote të vetë banorëve të Fshatit Seltë.

Me respekt

Këshilli kishtar

Organizata e Veteranëve

Këshilli i fshatit

Kryetari

Anastas Karaj



SELTË 25.06.2024


Kryetari

Petro Karaj



Kryetari

Kostandin Bica





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 9.314 prot

Elbasan me 18/9/2024

RELACION

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Bazuar në ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.” dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”, Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar nëpërmjet punonjësve social të saj të Sektorit të Shtresave në nevojë dhe Moshës së tretë pasi shqyrtoi kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur për vendosje në shërbimin rezidencial për të moshuar në Qendrën Sociale Balashe të bashkisë Elbasan, paraqet për sistemim si më poshte:

1. I moshuari Z. Stavri Stefan Skënderi, i datëlindjes 10.05.1949, vendbanimi Elbasan, Njesia Administrative Tregan, me nr. ID E90510234F, propozohet për t’u vendosur në qendrën e përkujdesit social për të moshuar pasi është i vetmuar, beqar. Jeton prej vitesh i vetëm. Nuk ka femijë dhe nuk ka askënd të kujdeset. I moshuari nuk ka shtëpi, ka jetuar në familjen e të vëllait, por momentalisht ai nuk mundet ta mbajë për shkak të moshës dhe nuk mund të kujdeset më për të. Aktualisht jeton në një shtëpi me qera afër shkollës Pedagogjike, por nuk e përballon dot qeranë dhe jetesën vetëm. Në këto kushte të ndodhura Z. Stavri Stefan Skënderi plotëson kriteret për tu akomoduar në azil.

Ky vendim i dërgohet Këshillit Bashkiak për vlerësim përfundimtar, bazuar në nenin 28 të ligjit 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë.

Duke ju falenderuar !

Konceptoi: Sp. A.Çoku

P/Sek: L. Senia

Drejtor i MPS: E. Kolla

Drejtor i Pergjithshem DPKSAR: D. Roseni

KRYETARI

Gledian Llatja

ME URDHËR E POROSI

ZV/KRYETARI

Armand Shehu





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ prot

Elbasan më ____ / ____ / 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ / datë ____ / 2024

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ / ____ / 2024 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar, bazuar në ligjin nr.121/2006 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.”, neni 28 dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”,

VENDOSI

Të miratojë vendosjen në Qendrën Sociale Balashe, në shërbimin rezidencial si më poshtë:

- I. I moshuari Z. Stavri Stefan Skënderi, i datëlindjes 10.05.1949, vendbanimi Nj.A Tregan, me nr. ID E90510234F.
- II. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes sociale si dhe Drejtoria e Qendrës Sociale Balashe.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori i Përgjithshëm

D. Rroseni

Drejtori Juridik

A.Hoxha

Drejtori Buxhet-Finance

A.Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Lutfi Lala

10 Shtator 2024

Sot, me datë 10 Shtator 2024, ora 09, mbledhet komisioni për vendosje në qendër të përkujdesit shoqëror residencial QSB.

J moshuari quhet Stavri Skenderi, i datëlindur 10.05.1949, është bepar, shoqëri dhe shoqëri askënd që të kujdeset për të.

Është në gjendje të kujdeset për nevojat e tij personale. Është person i qetë dhe pa probleme të shëndetit fizike mendor.

Komisioni i mbledhur ra dakort që L. Stavri Skenderi të priset në qendrën e QSB

Gjesmarrës në faktin:

1. Andriana Coku Specialiste e moshës ?
Bashkia e T
2. Vjollca Budani Nj VKSH. Sektori Shëndetit mendor
Inf. Inf.
3. Najada Ballo Inf. / Specialiste Sh. Mendor Nj VKSH
4. Dorana Sota Punëgjese Sociale Dr. Sh. S. S. H.
5. Eltona Tello Dr. M. P. S. Bashkia e T
6. Armand Shehu Zv. Kryetar




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Elbasan

Njësia administrative Tregan

Zyra e Gjendjes Civile 117



Data: 17.05.2024

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Data lindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Stavri SKËNDERI	Stefan	Vasli	M	Kryefamiljar	10-05-1949	Beqar/e	Shinavlash, Elbasan	Shqiptare	E90510234F
2.	-----									
3.	-----									
4.	-----									
5.	-----									
6.	-----									
7.	-----									
8.	-----									
9.	-----									
10.	-----									

Kjo certifikatë lëshohet për _____



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e
Përgjithshme e Gjendjes Civile
Data: 2024.05.17 12:11:50 +02'00'
df1621f5d7c36424daa50927c21e2e50f

LETËRNJOFTIM ID REPUBLIKA E SHQIPËRISE REPUBLIC OF ALBANIA

mbiemri/surname
Skënderi
emri/given name
Stavri
shtetësi/nationality
Shqiptare/Albanian
vendlindja/place of birth
Shinavlash, Elbasan
data e lindjes/date of birth
10-05-1949
data e lëshimit/date of issue
10-10-2013
autoriteti i lëshuesit/authority
MB

nr. letërnjoftimi/card no.
032321270

gjinia/sex
M
data e skadimit/date of expiry
09-10-2023
nr. personali/personal no.
E90510234F

firmat/signature






KËR KES

Unë i nëshkruari STAVRI SKËNDERI
Po ju (~~drejtues~~) drejtohem juve
si institucion të ndihmës sociale
me një kërkesë duke ju paragrafuar
nevojën time si mëposhtë vijon.

- 1) Unë jam i pa martuar, Pa grua.
- 2) Unë jam pa fëmijë.
- 2) Unë jam pa shtëpi.

Duke qenë me këto kushte

menoj se kërkesor ime do të
meret parasysh.

Me nderime dhe respekt

kërkuesi STAVRI SKËNDERI

(Stavri Skanderi)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
VËRTETIM**

**ZYRA VENDORE ELBASAN
VËRTETIM**

“PËR LËSHIM VËRTETIMESH (NEGATIV/POZITIV)”

Z/Znj. Stavri Stefan Skënderi

Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSCAD), rezulton se në emër të shtetasit:

Z/Znj. Stavri Stefan Skënderi

Nuk ka pasuri të regjistruara në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme.

Lëshohet sipas kërkesës nr. 9986, datë 21/06/2024.

DREJTORI
Adi Qose



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vëlosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)*

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Elbasan
Data: 2024/07/01 13:34:49 +02'00'
E90510234F202407011334426816N01



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 3533 prot.

Elbasan, më 12 . 08 .2024

RELACION

“Për miratimin e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë dhe vlerën maksimale të subvencionit të qirasë për vitin 2025”

KËSHILLIT BASHKIAK

KËTU

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 8 dhe neni 24, në ligjin nr.22/2018 “Për Strehim Social”, i ndryshuar, Kreu V “Subvencioni i qirasë”, neni 38, për përcaktimin e vlerës së subvencionit të qirasë në tregun e lirë, pika 1, VKM-së nr. 362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij.

Me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim të cilat me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë, duhet të miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak vlera maksimale e subvencionit të qirasë sipas nenit 38, pika 1 e ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar.

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, pika 4/a shprehet që për përcaktimin e vlerës së subvencionimit të qirasë në tregun e lirë, duhet ndër të tjera të përcaktohet vlera mesatare e qirasë në tregun e lirë.

Për realizimin e testimit të tregut, nga informacioni i marrë nga agjensitë imobiliare të cilat kanë dhënë informacionin mbi çmimet e referencës të qirave në territorin e Bashkisë Elbasan, dhe në bazë të këtij informacioni kemi llogaritur vlerat mesatare të qirave.

Qiratë mesatare të apartamenteve në treg të lirë për efekt subvencionimit të qirasë janë:

- Garsionere 10,000 lekë/muaj
- Apartament të tipit 1+1 10,000 lekë/muaj
- Apartament të tipit 2+1 12,000 lekë/muaj
- Apartament të tipit 3+1 15,000 lekë/muaj

KRYETARI
Gledian Llatja

Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Armand Shehu

Spektori Strehimit: A. Beqiri E. Ibërshimi
Drejtoria P.K.S.A.R: D. Roseni
Drejtoria F.B: A. Merkja
Drejtoria Juridike: A. Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ prot.

Elbasan, më _____. _____. 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë ____/____/2024.

“Për miratimin e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë dhe vlerën maksimale të subvencionit të qirasë për vitin 2025”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____/____/2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale (Sektori Strehimit), “Për miratimin e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë dhe vlerën maksimale të subvencionit të qirasë për vitin 2025”, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 8 dhe neni 24, në ligjin nr.22/2018 “Për Strehim Social”, i ndryshuar, Kreu V “Subvencioni i qirasë”, neni 38, për përcaktimin e vlerës së subvencionit të qirasë në tregun e lirë, pika 1, VKM-së nr. 362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij,

V E N D O S I:

- 1) Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Elbasan, si më poshtë:
 - Garsionere 10,000 lekë/muaj
 - Apartament të tipit 1+1 10,000 lekë/muaj
 - Apartament të tipit 2+1 12,000 lekë/muaj
 - Apartament të tipit 3+1 15,000 lekë/muaj
- 2) Vlerat e përcaktuara në pikën 1 përbëjnë dhe vlerën maksimale të subvencionit të qirasë sipas strukturave përkatëse për vitin 2025.
- 3) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Strehimit.
- 4) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Elvi Çuni

Konceptoi: A. Beqiri

E. Ibërshimi

Drejtoria P.K.S.A.R

D. Roseni

Dr. Juridike: A. Hoxha

Zv/Kryetar: A. Shehu

KRYETARI

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 4316 Prot.

Elbasan, më: 18.09.2024.

RELACION

“Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan”.

KËSHILLIT BASHKIAK

K Ë T U

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës për marrdhëniet familjare”, i ndryshuar, V.K.M nr. 327 datë 02.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjës për referimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimi-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social, Arsimit dhe Rinisë i relaton Këshillit Bashkiak si më poshtë:

Bashkia Elbasan ka kontratë qiramarrje me Forumin e Gruas Elbasan dhe Znj. Liri Kasa e cila përfundon më datë 14.09.2024.

Pranë Bashkisë Elbasan është paraqitur kërkesa me nr. 3770 prot, datë 06.08.2024 “Kërkesë për rinovim kontrate”, për pasurinë nr. 25/10+1-3/1 me sipërfaqe 98.5 m², ndodhur në Z.K. 8525, Lagja “5 Maj”, për t’a përdorur si strehëz emergjence për gratë dhe vajzat e mbijetuara nga dhuna në familje, sipas dokumentacionit bashkëlidhur. Për sa më sipër, dhe në zbatim të pikës III (Afati i Kontratës) që përfundoi, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimi-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social, Arsimit dhe Rinisë i relaton Këshillit Bashkiak të miratojë marrjen me qira (rinovim kontrate), për ambientin që do të përdoret si (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan, për periudhën (një) vjeçare nga data 15.09.2024 deri 14.09.2025, me vlerë qiramarrje prej 23000 lekë/muaj me të njëjtat kushte të kontratës si në vitin e kaluar.

Konceptoi: A. Braneshi

Drejtoria P.P:

Drejtoria B.F:

Drejtoria e P.P.ZH.U.SH.I:

Drejtoria P.K.S.A.R:

A. Pisha

A. Suli

A. Merkja

D. Meta

D. Roseni

Me urdhër e porosi

ZV/KRYETAR

Aulona Bylykbashi

KRYETARI

Gledian Llatja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më: ____ .09.2024.

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____ Datë: ____ .09.2024.

“Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan”.

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës për marrdhëniet familjare”, i ndryshuar, V.K.M nr. 327 datë 02.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjës për referimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .09.2024, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimi- Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social, Arsimit dhe Rinisë i relaton Këshillit Bashkiak, “Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan”;

VENDOSI:

1. Miratimin marrje me qira ambjentin me sipërfaqe 98,5 m², ndodhur në Z.K. 8525, Lagja “5 Maj”, për periudhën 1 (një) vjeçare nga 15.09.2024 deri 14.09.2025, me vlerë qiramarrje prej 23000 lekë/muaj, për t’a përdorur (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimi- Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social, Arsimit dhe Rinisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Elvi Çuni

KRYETARI
Lutfi Lala

Konceptoi: A. Braneshi
Drejtoria P.P.:
Drejtoria B.F.:
Drejtoria e P.P.ZH.U.SH.I:
Drejtoria P.K.S.A.R.:
Drejtoria J. I:
Zv/Kryetari:

A. Pisha
A. Suli
A. Merkja
D. Meta
D. Roseni
A. Hoxha
A. Bylykbashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 3567 Prot.

Elbasan, më: 22.07.2024.

RELACION

“Për miratimin në parim të hapjes së gjurmës së re të rrugës Dopaj-Funar dhe nisjen e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve që preken nga ky projekt.”

KËSHILLIT BASHKIAK
K Ë T U

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjin Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; V.K.M Nr. 205 datë 21.02.2008 “Për miratimin e listës së Inventarit të Pronave të Paluajtëshme shtetërore, në Komunën Gracen, të Qarkut të Elbasanit”, VKM nr.888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”; V.K.M Nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive” i ndryshuar Ju propozojmë si në vijim:

Subjekti privat “Vëllezërit Hysaj” Sh.P.K, të cilit i është miratuar leja minerare nr. 1932 datë 18.05.2022 nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise për veprimtarinë e shfrytëzimit të gurit gëlqeror, leje nga e cila i lind detyrimi për ndërtimin e infranstrukturës së përcaktuar në leje.

Në këto kushte ky subjekt i është drejtuar Bashkisë Elbasan me shkresën Nr.904/1 Prot., datë 21.02.2022, për realizimin e një bashkëpunimi, i cili parashikon hartimin e plotë të projektit për infrastrukturën rrugore Dopaj(autostrada Tiranë-Elbasan) - Funar si dhe investimin për zbatimin e projektit në segmenti Dopaj-Leja Minerare 2568 m.

Ky aks rrugor është pjesë e rrugës që lidh fshatin Dopaj me zonën e liqeneve të fshatit Funar dhe vazhdon deri në fagen e malit, zonë e cila spikat për bukuritë natyrore të pyjeve, liqeneve, frutikulturave, etj., por që aktualisht aksesimi është problematik pasi terreni është mjaft i vështirë.

Bashkia Elbasan e ka patur në fokus të projekteve të saj ndërtimin e infrastrukturës në këtë aks të ri duke qenë se synon nxitjen e investimeve në promovimin e zonave me potencial turistik nëpërmjet instrumentave strategjikë .

Rruga aktuale që lidh Elbasanin me Funarin pavarësisht investimeve të pjeshme që i janë bërë mbetet një rrugë e vështirë, me shumë kthesa dhe shtrihet në një terren të vështirë, çka e bën atë jo të përdorshme në çdo stinë të vitit dhe nga çdo lloj mjeti.

Nisur nga sa më sipër, gjurma e projektit të paraqitur *shtrihet në pasuritë e detajuara në planvendosjen bashkëlidhur*, ku një pjesë e të cilave janë në pronësi të Bashkisë Elbasan, ndërsa për pasuritë e tjera do të merret dakortësimi i Institucioneve përkatëse.


Në kuadër të këtij projekti, Bashkia përfiton projektin e hartuar nga subjekti privat sipas detyrës së projektimit të hartuar nga Bashkia Elbasan dhe investimin e segmentit nga fshati Dopaj deri në zonën minerare për të cilën subjekti “Vëllezërit Hysaj” Sh.P.K, është i pajisur me leje minerare nr. 1932 datë 18.05.2022 nga Ministria e Infrastrukturs dhe Energjise për veprimtarinë e shfrytëzimit të gurit gëlqeror.

Cdo pasuri që preket nga ky investim nuk do të tjetërsohet në pronësi dhe e gjithë infrastruktura rrugore e re do të regjistrohet në pronësi të bashkisë.

Të dhënat teknike të objektit janë si mëposht:

- Segmenti Dopaj-Funar 7806 m
- Segmenti Dopaj-Leja Minerare 2568 m
- Nga km 0 deri tek 1450 m është segment i perbashket për të dyja segmentet
- Segmenti (rruga e kantierit) 2568-1450=1118 m
- Total të dyja segmentet rrugore 7806+1118=8924 m (8.9 km)

PLANVENDOSJA E RRUGES DOPAJ-FUNAR



Figuro 3: Aksii rruges

Kjo gjurmë e re rrugore me një gjatesi totale prej 6379 m do të hapet trase e re e gjitha me një gjerësi rruge 6.0 m dhe me bankina 0.75 m në të dy krahët e rrugës.

Ky aks i ri që do të ndërtohet do të bazohet kushteve të projektimit dhe do të plotësoj këto parametra:

- Gjerësi asfalti 6.0 m
- Bankina, në të dy krahët e rrugës me gjerësi 0.75 m
- Gjerësia e përgjithshme e kurorës së rrugës 6.5 m
- Shpejtësi të projektuar 30 km/ore.
- Intensiteti i trafikut 30 – 50 automjete njësi.

Pjesa tjetër e investimit do të mbulohet nga Bashkia Elbasan menjëherë me krijimin e burimeve të financimit.

Për sa më sipër, Ju propozojmë miratimin në parim të hapjes së gjurmës së re të rrugës Dopaj-Funar dhe nisjen e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve që preken nga ky projekt.

KRYETARI
Gledian Llatja

Me urdhër e porosi

ZV/KRYETAR

Aulona Bylykbashi



Drejtorja P. F.Boja

Drejtorja P.Zh.T

Drejtorja e Pyjeve

Specialisti Kadastrës Pyjore

Drejtorja P.P.: A. Pisha

Drejtorja P.P.Zh.U.Sh.I.:

B.Korumi


A. Muhametaj

K.Gripshi

A.Muca

A.Branexhi

D. Meta



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më _____. _____. 2024

Projekt – Vendim

Nr _____ Datë _____ / _____ /2024

“Për miratimin në parim të hapjes së gjurmës së re të rrugës Dopaj-Funar dhe nisjen e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve që preken nga ky projekt.”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/____/2024, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë në lidhje me projektin për zhvillimin infrastrukturor për hapjen e rrugës së re Dopaj – Funar, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 23 54 të tij, ligjin Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; V.K.M Nr. 205 datë 21.02.2008 “Për miratimin e listës së Inventarit të Pronave të Paluajtëshme shtetërore, në Komunën Gracen, të Qarkut të Elbasanit”, VKM nr.888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”; V.K.M Nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive” i ndryshuar,

Vendosi

- 1- Të miratojë në parim hapjen e rrugës së re Dopaj – Funar, rrugë rurale me gjatësi 7806 m, sipas plan-vendosjes bashkangjitur dhe pjesë e këtij vendimi.
- 2- Zbatimi i projektit për ndërtimin e rrugës të bëhet sipas kriterëve dhe standarteve teknike-ligjore të parashikuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
- 3- Subjekti kërkues i paisur me leje minerare nr. 1932 datë 18.05.2022 nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji për veprimtarinë e shfrytëzimit të gurit gëlqeror, të ndërtojë pjesën e parë, segmentin e rrugës nga Segmenti Dopaj-Leja Minerare 2568 m.
- 4- Bashkia të marrë masat për gjetjen e burimeve të financimit për pjesën tjetër të projektit.

- 5- Agjensia e Pyjeve Bujqësisë e Mjedisit të nis procedurat për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve që preken nga ky projekt.
- 6- Ngarkohen Drejtoria e Pëgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore dhe Agjensia e Pyjeve Bujqësisë e Mjedisit me zbatimin e këtij vendimi
- 7- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

D.P.	M Avllazagaj	
D.P.ZH.T.	A. Muhametaj	
D.P.P	A.Pisha	
D.Juridike	A. Hoxha	
A.P.B.M.	Sh. Çullhaj	

Sek. K. Bashkiak
E. Çuni

Kryetari
L. Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT URBAN DHE
SHËRBIMEVE INFRASTRUKTURE
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 4376 Prot.

Elbasan më 23.09.2024

RELACION

Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Ymer Avdi Isaku banor në fshatin Qerret të Njësisë Administrative Labinot Mal dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Mbrojtjes Civile,

Në zbatim të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Drejtoria e Emergjencave Civile pas marrjes së njoftimit verbalisht si edhe me shkresë zyrtare 673 prot. datë 2.4.2024 për djegien e banesës së **Z. Ymer Avdi Isaku**, banor në fshatin Qerret të Njësisë Administrative Labinot Mal, (kërkesë e kryer nga z. Xhemal Ymer Isaku) në datë 31.3.2024 (konfirmuar edhe nga Vërtetimi i SHMZSH nr. 09 datë 2.4.2024), ka verifikuar më datë 1.4.2024 pas njoftimit verbal të bërë, dëmet që kishte pësuar banesa dhe mbajtëm proces-verbalin përkatës të datës 1.4.2024. Pas plotësimit të dokumentacionit, është vijuar me përcjelljen e dokumentacionit komisionit të vlerësimit të dëmeve ngritur në Bashkinë Elbasan me Urdhër 2680/2 date 05.04.2024 nga Kryetari i Bashkisë “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 2680/1 datë 9.2.2024 “Per ngritjen e komisionit per vleresimin e dëmeve te shkaktuara ne objekte banimi nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi te tjera””, për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga ekspertët e këtij komisioni. Ky komision, ka përgatitur preventivin mbi vlerën e dëmeve të objektit nga ana ndërtimore (sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin përkatës ose sipas çmimeve në fuqi, sipas zërave të punimeve të ndërtimit, miratuar nga Këshilli i Ministrave për Entin Kombëtar të Banesave) dhe preventivin me vlerën e pajisjeve dhe orendive të dëmtuara (mbështetur në çmimet mesatare aktuale të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve ndërtimore në banesën e **Z. Ymer Avdi Isaku**, është në masën **2,197,347 (dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzet e shtatë) lekë.**

- Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi e Z. Ymer Avdi Isaku, është në masen 675,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.


Në bazë të VKM-së cituar më sipër nr. 329 datë 16.05.2012 vlera e dëmeve në banesën e përcaktuar nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë merret nga pronari në masën prej 50% të shumës së nxjerrë. Pra në këtë rast $2,197,347^1 \times 50\% = 1,098,673$ lekë.

Kësaj shume i shtojmë edhe vlerën prej 675,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë që është vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi.

Në përfundim nga komisioni i Vlerësimit të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Ymer Avdi Isaku, i takojnë $1,098,673 + 675,000 = 1,773,673$ (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

Duke Ju falenderuar,

<u>Konceptoi:</u>	Specialist	I. Hoxholli
<u>Pranoi:</u>	Përgj. Sektori	Xh. Kapllanaj
<u>Miratoi:</u>	Drejtori EC	N. Sinani
<u>Konfirmoi:</u>	Drejtori PSHI	D. Meta



KRYETARI
Gledian Llatja

ME URDHËR E POROSI

ZV/KRYETARI
Asim Sula



¹ Vlera e dëmeve në banesë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, _____._____.2024

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë _____._____.2024

Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Ymer Avdi Isaku banor në fshatin Qerret të Njësisë Administrative Labinot Mal dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr. 329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 26 datë 28.03.2024 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2024" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile;

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së Z. **Ymer Avdi Isaku**, në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është ne **1,773,673 (një milion e shtatëqind shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë**.
2. Kjo vlerë është rezultat i 50% të vlerës së preventivit të dëmeve ndërtimor në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. $2,197,347^1 \times 50\% = 1,098,673 + 675,000^2 = 1,773,673$ lekë.
3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2024, i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 26 datë 28.03.2024 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2024".

¹ Vlera e dëmeve ndërtimore në banesë

² Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elvi Çuni

Lutfi Lala

Konceptoi:

Specialist

I. Hoxholli

Pranoi:

Përgj. Sektori

Xh. Kapllanaj

Miratoi:

Drejtori EC

N. Sinani

Konfirmoi:

Dr. Juridike


A. Hoxha

Dr. PPZhUSHI

D. Meta

Zv/Kryetari

A. Sula



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT URBAN DHE
SHËRBIMEVE INFRASTRUKTURE
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Elbasan më 1/4/2024

Proces – Verbal Konstatimi

Mbështetur në shkresën me nr. 673 prot. datë 02/04/2024, ardhur pranë Drejtorisë së Emergjencave Civile, Bashkia Elbasan, me anë të cilës z. Ymer Isaku (nëpërmjet djalit të tij z. Xhemal Ymer Isaku) banues në fshatin Qerret, të Njësisë Administrative Labinot Mal, ngre shqetësimin e tij lidhur me dëmtimet që ka pësuar objekti (shtëpi banimi) në pronësi të tij nga rënia e zjarrit në banesë me datë 31/03/2024 (konfirmuar dhe nga dokumenti i lëshuar nga SH.M.Z.SH me nr. 9 datë 02.04.2024), specialistët e Drejtorisë së Emergjencave Civile, shkuan dhe verifikuan në vend situatën:

Nga verifikimet në objekt rezultoi si më poshte :

Pronaret e objektit : z. Ymer Avdi Isaku

Vendndodhja e objektit : Fshati Qerret, Njësia Administrative Labinot Mal

Sipërfaqja e objektit (shtëpi banimi 1 kat) te demtuar eshte : 218.5 m²

Komisioni konstatoi se në banesën e z. Ymer jetonin dy djemtë e tij sëbashku me bashkëshortet dhe fëmijët, pra në total nëntë persona. Ambjenti i banimit ishte përshtatur në 2 banesa të ndara nën të njëjtës çati. Objekti është ndertese 1 kateshe, me themele të vazhdueshme, me murature guri me gjerësi 60 cm dhe murature blloku 15cm sipas planimetrisë, me dyshe me lluster çimento, dyer të brendshme druri dhe dera e jashtme duro alumini, dritare duro alumini dhe druri, tavan derrase, dhe çati lende druri mbuluar me tjegulla vendi. Instalimet elektrik është demtuar komplet. Gjate matjeve të bëra me datë 01/04/2024 rezultoi se zjarri i rënë në objektin (shtëpi banimi 1 kat), ka shkrumbuar komplet ambjentet e shtëpisë dhe të gjitha orënditë brenda.



Në shtëpinë e banimit janë djegur komplet dyert e brendshme druri (cope 8), dyer duralumini të brendshme (cope 2), dyer duralumini të jashtme (cope 2), derë metalike e jashtme (copë 1) dritare duralumini (cope 11), dritare druri (cope 1). Instalimet elektrike ishin djegur dhe shkatërruar totalisht. Tavanet e banesës janë me materiale dërrase dhe janë djegur totalisht. Suvatimet e mureve të brendshme janë demtuar rreth 70 % ndërsa suvatimet e jashtme në masën 70%.


Pajisjet dhe orënditë që janë inekzistente pasi janë djegur komplet nga zjarri, janë djegur bufeja e kuzhinës (cope 2), kolltuk dopjo (cope 1), kolltuk tek (cope 2), krevat tek + dyshek


(cope 5), krevat dopio + dyshek (cope 2), karrike (cope 15), televizore (cope 2), frigorifer (cope 2), tavoline e zakonshme salloni (cope 2), tavoline buke (cope 2), sobe elektrike (cope 2), furre me mikrovalë (cope 1), furrë elektrike (copë 2) dollap rrobash (dhome gjumi) (cope 3), lavatriçe (cope 2), komedine (cope 4), divane (cope 8), minibar (copë 1), makineri per skremues qumeshti (cope 1), motorrsek (cope 1), etj.

Rrjeti elektrik eshte demtuar komplet, priza brenda murit (cope 22), celesa brenda murit (cope 13), mates energjie (copë 2), kasete elektrike (cope 2),

Çfarë u përshkrua më sipër shoqërohet me fotot përkatëse:







Ky Proces – Verbal pasi u lexua u firmos nga komisioni, Administratori i Njesisë Administratori Labinot Mal dhe pronari i baneses.

KOMISIONI

Spec. Halit Çehu

Ing. Baftjar Shypheja

Ing. Arjan Baku

PRONARI I BANESES

Ymer Avdi Isaku

me prokurë të përgjithshme

Xhemal Ymer Isaku

Administratori i Njesisë Administratori Labinot Mal
Ylber Kuçi

**MIRATOHET
DREJTORI I EMERGJENCAVE CIVILE**

Ndriçim Sinani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT URBAN DHE
SHËRBIMEVE INFRASTRUKTURE
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Elbasan më 08/04/ 2024

Proces – Verbal Vlerësimi

Ky proces – verbal mbahet sot 08.04.2024 ne zbatim te urdherit te brendshem te Kryetarit te Bashkise Elbasan nr. 2680/2 date 05.04.2024 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 2680/1 datë 9.2.2024 “Per ngritjen e komisionit per vleresimin e demeve te shkaktuara ne objekte banimi nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi te tjera”” i perbere nga Ing. Xhevair Kapllanaj , Ing. Elton Hamataj, Ark . Klajdi Haxhihyseni, Ek. Nevila Dybeli, Ju. Irida Hoxholli për djegien e banesës së **Z. Ymer Avdi Isaku** banues ne fshatin Qerret, Njësia Administrative Labinot Mal.

Nga verifikimet ne objekt rezultoi si me poshte :

Pronaret e objektit : Z. Ymer Avdi Isaku

Vendndodhja e objektit : Fshati Qerret, Njësia Administrative Labinot Mal.

Zona Kadastrale ZK. 3100, Pasuria Nr. 168/8, Indeksi i Hartes K -34 – 101- (87-C) , Kordinatat ne sitemin kordinativ KRGJSH : X = 4564372.31; Y = 516716.44

Siperfaqja e banesës eshte : 218.5 m²

Siperfaqja e objektit (shtepi banimi 1 kat) e demtuar eshte: 218.5 m²

Objekti eshte ndertese 1 kateshe, me themele te vazhdueshem, me murature guri me gjeresi 60 cm dhe murature blloku 15cm sipas planimetrise, me dysHEME lluster çimento, dyer e brendeshme druri dhe dera e jashtme duro alumini, dritare duro alumini dhe druri, tavan derrase, dhe çati lende druri mbuluar me tjegulla vendi. Istalimet elektrik eshte demtuar komplet. Gjate matjeve te bera me date 01/04/2024 rezultoi se zjarri i rënë në objektin (shtëpi banimi 1 kat), ka shkruar komplet ambjentet e shtëpisë dhe të gjitha orënditë brenda.

Ne shtëpinë e banimit jane djegur komplet:

1. dyert e brendshme druri (cope 8),
2. dyer duralumini të brendshme (cope 2),
3. dyer duralumini të jashtme (cope 2),
4. derë metalike e jashtme (copë 1)
5. dritare duralumini (cope 11),
6. dritare druri (cope 1).

Instalimet elektrike ishin djegur dhe shkaterruar totalisht. Tavanet e baneses jane me materiale dërrase dhe janë djegur totalisht. Suvatimet e mureve te brendshme jane demtuar

rreth 70 % ndersa suvatimet e jashtme ne masen 70%.





Pajisjet dhe orendite qe jane inekzistente pasi jane djegur komplet nga zjarri, jane djegur


- | | |
|---|---|
| 1. bufeja e kuzhinës (cope 2), | 11. sobe elektrike (cope 2), |
| 2. kolltuk dopjo (cope 1), | 12. furre me mikrovalë (cope 1), |
| 3. kolltuk tek (cope 2), | 13. furrë elektrike (copë 2) |
| 4. krevat tek + dyshek (cope 5), | 14. dollap rrobash (dhome gjumi) (cope 3), |
| 5. krevat dopio + dyshek (cope 2), | 15. lavatriçe (cope 2), |
| 6. karrike (cope 15), | 16. komedine (cope 4), |
| 7. televizore (cope 2), | 17. divane (cope 8), |
| 8. frigorifer (cope 2), | 18. minibar (copë 1), |
| 9. tavoline e zakonshme salloni (cope 2), | 19. makineri per skremues qumeshti (cope 1), |
| 10. tavoline buke (cope 2), | 20. motorrsek (cope 1), etj. |

Rrjeti elektrik eshte demtuar komplet, priza brenda murit (cope 22), celesa brenda murit (cope 13), mates energjie (copë 2), kasete elektrike (cope 2),

Përshkrimi i mësipërm shoqërohet me fotot përkatëse.







Ky Proces – Verbal pasi u lexua u firmos nga komisioni, Administratori i Njesisë Administratori Labinot Mal dhe pronari i baneses.

KOMISIONI

Ing. Xhevahir Kapllanaj

Ing. Elton Hamataj

Ark. Klajdi Haxhihyseni

Ju. Irida Hoxholli

Ek. Nevila Dybeli

PRONARI I BANESES

Ymer Avdi Isaku

me prokurë të përgjithshme

Xhemal Ymer Isaku

Administratori i Njesisë Administratori Labinot Mal
Ylber Kuçi

**MIRATOHET
DREJTORI I EMERGJENCAVE CIVILE**

Ndriçim Sinani




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Elbasan

Njësia administrative Labinoth-mal

Zyra e Gjendjes Civile 109



Date: 02.04.2024

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Xhemal ISAKU	Ymer	Bajame	M	Kryefamiljar	11-04-1987	I/e martuar	Qerret, Elbasan	Shqiptare	I70411023F
2.	Flutur ISAKU	Skënder	Minushe	F	Bashkëshorte	08-11-1990	I/e martuar	Cërrojë, Elbasan	Shqiptare	J06108061W
3.	Rozalina ISAKU	Xhemal	Flutur	F	E Bija	02-11-2008	Begar/e	Elbasan	Shqiptare	K86102059M
4.	Hekuran ISAKU	Xhemal	Flutur	M	I Biri	02-03-2010	Begar/e	Elbasan	Shqiptare	L00802067F
5.	-----									
6.	-----									
7.	-----									
8.	-----									
9.	-----									
10.	-----									

Kjo certifikatë lëshohet për Dokument



Vulosur elektronikisht nga Drejtorja e
Përgjithshme e Gjendjes Civile
Date:2024/04/02 10:10:32 +02:00
I70411023F2024040210102381F001




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Elbasan

Njësia administrative Labinot-mal

Zyra e Gjendjes Civile 109



Datë: 02.04.2024

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Ymer ISAKU	Avdi	Fatime	M	Kryefamiljar	15-06-1947	I/e ve	Qerret, Elbasan	Shqiptare	E70615148S
2.	-----									
3.	-----									
4.	-----									
5.	-----									
6.	-----									
7.	-----									
8.	-----									
9.	-----									
10.	-----									

Kjo certifikatë lëshohet për

Dokument



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e
Përgjithshme e Gjendjes Civile
Data: 2024/04/02 10:30:13 +02'00'
E70615148S2024040210300476F001



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHMZSH

Nr. 83/1 Prot.

Elbasan më 02 . 4 .2024

VËRTETIM

Për rënie zjarri

Nr.09, Datë 02.04.2024

Vërtetohet se më datë 31.03.2024, rreth ores 15:15', ne fshatin Qerret, Njesia Adm. Labinot-Mal bashkia Elbasan, ka rene zjarr ne banesen ne perdorim te shtetasit Ibrahim Isaku dhe ne pronesi te babit te tij Ymer Isaku.

Per zjarrin e rene eshte njoftuar Sherbimi zjarrfikes dhe ka marre pjese me nje mjet zjarrfikes dhe tre zjarrfikes.


Nga renia e zjarrit eshte djeg komplet banesa me kater dhoma, me gjithcka qe kishte brenda dhe catia.

Stacioni i MZSH-së Elbasan disponon dokumentacionin përkatës që vërteton këtë rast zjarri.

Ky vërtetim mbahet në 2 (dy) kopje dhe përpilohet me kërkesën e të dëmtuarit nga zjarri.

DREJTORI I SHËRBIMIT TË MZSH-së ELBASAN





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

PREVENTIV I BAZES MATERIALE TE DJEGUR

Emertimi i objektit : Banese e demtuar nga djegia ne fshatin Qerret , Njesia Administrative Labinot Mal , Bashkia Elbasan .
Pronari i objektit: z. Ymer Isaku

Vendodhja e baneses :Fshatin Qerret , Njesia Administrative Labinot Mal , Bashkia Elbasan

Siperfaqja totale e ndertesës: 218.5 m2

Siperfaqja e djegur e banesës : 218.5 m2

Vlera e perlogaritur : 675,000 leke

Nr	Nr.analize	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	4	Televizor	cope	2	25000	50,000
2	3	Frigorifere	cope	2	22000	44,000
3	13	Lavatrice	cope	2	27000	54,000
4	14	Divane	cope	8	8000	64,000
5	1	Kolltuk tek	cope	2	20000	40,000
5	15	Bufe guzhine	cope	2	6000	12,000
6	16	Minibar	cope	1	15000	15,000
7	2	Furre elektrike	cope	2	20000	40,000
9	5	Karrike te zakonshme	cope	15	1000	15,000
10	4	Tavoline e zakonshme salloni	cope	2	3000	6,000

11	10	Tavoline buke		cope	2	5000	10,000
13	9	Dollap rrobash (dhome gjumi)		cope	3	17000	51,000
13	12	Krevat (dhome gjumi) femijesh		cope	5	10000	50,000
14	13	Komodine		cope	4	1000	4,000
15	9	Krevat dopio (dhome gjumi) + dyshek		cope	2	85000	170,000
16	1	Sobë elektrike		cope	2	22000	44,000
17	10	Furrë me mikrovalë		cope	1	6000	6,000
18		Sobë me dru		cope	0	0	-
19		Perde		cope	0	0	-
20		Tapet		cope	2	0	-
		SHUMA					675,000
				Leke			

Ky preventiv është llogaritur me çmimet në fuqi miratuar nga Këshilli I Ministrave për Entin Kombëtar të banesave bazuar pikës III/3/b ,të VKM- së nr.329, datëe 16.05.2012" Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

Vlerësimi i datës 8.4.2024 është bere ne baze te demeve shkaktuar nga zjarri i rënë në banesë

Komisioni

Ing. Xhevahir Kapllana

Ing. Elton Hamataj

Ark. Klajdi Haxhihyseni

Ju. Irida Hoxholli

Ekon. Nevila Dybeli

Drejtori i Emergjencave Civile


Ndriçim Sinani

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISE

Gledian Llatja





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

PREVENTIV I DËMEVE NDËRTIMORE

Emertimi i objektit : Banese e demtuar nga djegia ne fshatin Qerret , Njesia Administrative Labinot Mal , Bashkia Elbasan .

Pronari i objektit: z. Ymer Isaku

Vendodhja e baneses :Fshatin Qerret , Njesia Administrative Labinot Mal , Bashkia Elbasan

Siperfaqja totale e ndërtësës: 218.5 m2

Siperfaqja e djegur e banesës : 218.5 m2

Vlera e perlllogaritur : 2,197,347 leke

Nr	Nr analizes	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
I		Punime Ndertimi				
1	426/2	Prishje mur guri + blloqe (demtuar mbi masen 60%)	m3	70.63	534	37,714
2	54/1	Mur guri lartesi + llac M-15	m3	59.38	7034	417,683
3	88	Mure me blloqe betoni b=30 cm	m3	11.25	5316	59,781
4	310	Suvatim i brendshem muri tulle me llaç te perzier (Suvatim i brendshem mur guri me llaç te perzier M 25 demtuar 100%)	m2	249.98	685	171,239
5	334	Suvatim i jashtem i zakonshem me llaç te perzier	m2	111.02	685	76,049
6	17	Tavan me veshje druri	m2	163.54	2583	422,416
7	264	Shrese lluster cimento 1:2	m2	163.54	337	55,112
8	399	Sherbetim me gelqere pa pigment	m2	554.40	48	26,611
9	227	Cati me tjegulla marsejeje pa lluster.K.D.h.d-6m.	m²	218.50	2284	499,054

10	An	Dyer te brendeshme tamburato te thjeshta	m ²	14.60	9725	141,985
11	An	Fv. Dyer d/alumini me mentesha tek xham	m ²	7.40	10401	76,967
12	An	Fv. Dritare duralumini rreshqitese tek xham spesor 1.3mm	m ²	14.03	8200	115,046
13	An	Vetrata druri me punime	m ²	0.25	7950	1,988
		Shuma I				2,101,646
II		Punime Elektrike				
1	482/An	Percjelles bakri P.V. - 500 4mm2	ml	100	94	9,400
2	482/An	Percjelles bakri P.V.-500 2.5mm2	ml	250	71	17,750
3	An	Kuader brenda ap.me 5aut.+1 celes elektomanjetik (salvavita)	cope	2	6132	12,264
4	483	Fv. Çelesa te zakonshem brenda murit	cope	13	497	6,461
5	483	Fv. Priza te zakonshem brenda murit 10 A	cope	22	497	10,934
6	486	Fv. Portollampa normale 10 A	cope	16	217	3,472
7	487	Fv.Kuti plastike çelesa + priza	cope	22	102	2,244
8	480/1	Fv. Tuba plasmasi fi18-21 mm	ml	100	102	10,200
9	480/2	Fv. Tuba plasmasi fi 21 -26 mm	ml	50	134	6,700
		Shuma II				79,425
III		Punime Hidraulike + hidrosarnitare				
1	495	F.v lavaman cilesi e II - te + grup	cope	1	7993	7,993
2	502	F.v ëC Cilesi II - te + kasete plastike	cope	1	8283	8,283
		Shuma III				16,276
		Shuma (I+ II + III)				2,197,347

Ky preventiv është llogaritur me çmimet në fuqi miratuar nga Këshilli I Ministrave për Entin Kombëtar të banesave bazuar pikës III/3/b ,të VKM- së nr.329, datë 16.05.2012" Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

Vlerësimi është bërë në bazë të dëmeve në struktura të banesës, pasi kjo banesë është e pabanueshme

Komisioni

Ing. Xhevahir Kapllanaj

Ing. Elton Hamataj

Ark. Klajdi Haxhihyse

Ju. Irida Hoxholli

Ekon. Nevila Dybeli

Drejtori i Emergjencave Civile

Ndriçim Sinani

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISE

Gledian Llatja

